

Znj. Ermira Vojka ka përfunduar studimet e larta në vitin 2004 në Universitetin Bujqësor të Tiranës, duke fituar titullin “Inxhinier Agrar”. Në vitin 2016 ka përfunduar studimet për “Financë-Kontabilitet” në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Ajo ka një eksperiencë prej rreth 6 vite në sektorin privat, ndërsa në Kontrollin e Lartë të Shtetit ka mbi 11 vite eksperiencë. Që nga viti 2012 ka ushtruar detyrën e specialistes apo auditueses në departamentet e auditimit dhe nga viti 2018 ka qenë në pozicionin e Auditueses së Lartë.

Aktualisht Znj. Vojka ushtron detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Gjatë karrierës së saj ka ndjekur disa trajnime të rëndësishme ndërkombëtare për rritjen e kapacitetit profesional si:

- Në vitin 2018, ka ndjekur programin 5 mujor të “Internship”-it në Gjykatën Evropiane të Audituesve (ECA), në Luksemburg, ku ka qenë pjesë e Departamentit “Përdorimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore”.

- Në vitin 2019, ka qenë pjesë e programit të trajnimit 4 mujor, “International Auditor Fellowship Program”, në GAO – “Zyra e Llogaridhënies së Qeverisë së SHBA-ve”, në Washington DC, ku ka ndjekur 640 orë trajnime në fushën e auditimit, drejtimit dhe zhvillimit personal të përbërë nga kurse, seminare dhe e-learning, si dhe ka përgatitur punimin strategjik përkatës.

Gjithashtu, në vijimësi ka marrë pjesë në trajnime, konferenca, seminare, të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, në tema që lidhen me auditimin e jashtëm.

Znj. Vojka është njohëse shumë e mirë e gjuhës angleze dhe gjuhës italiane.